

V E N D I M
Nr.402, datë 10.3.1999

PËR MIRATIMIN E KREUT TË PARË TË STATUTIT TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR "EMËRIMI DHE SHKARKIMI I STAFIT DREJTUES TË RTSH-SË"

Në mbështetje të nenit 143 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 88 të Rregullores, me propozimin e Këshillit drejtues të RTSH-së,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. Miratohet kreu i parë i statutit të Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH) "Emërimi dhe shkarkimi i stafit drejtues të RTSH-së", si vijon:

STATUTI I RTSH

KREU I
EMËRIMI DHE SHKARKIMI I STAFIT TË RTSH

1. Kriteret e përzgjedhjes dhe të emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm
 - 1.1. Kriteret për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së janë:
 - të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë,
 - të ketë kryer arsimin e lartë,
 - të jetë intelektual me veprimtari krijuese publike,
 - të ketë përvojë pune në media ose në administrimin publik jo më pak se 5 vjet,
 - të ketë aftësi drejtuese e menaxhuese dhe ide të qarta për zhvillimin e radiotelevizionit publik
 - 1.2. Kandidatët duhet të paraqesin në Këshillin Drejtues të RTSH-së, sipas kërkesave që përcakton ligji, curriculum vitae të plotë, platformën dhe idetë e tyre për RTSH publik, strukturën programore dhe organizative të sistemit të RTSH-së, planin e menaxhimit për veprimtarinë prodhuese e financiare të RTSH-së.
2. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm
 - 2.1. Këshilli Drejtues i RTSH-së shpall publikisht kriteret e konkurrit për drejtor të përgjithshëm.
 - 2.2. Kandidatët për drejtor të përgjithshëm paraqesin me zarf të mbyllur te Kryetari i Këshillit Drejtues të RTSH-së dokumentacionin, sipas kriterëve të shpallura brenda 10 ditëve pas publikimit të tyre.
 - 2.3. Këshilli Drejtues bën përzgjedhjen e kandidaturave të paraqitura në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, verifikon dhe saktëson vërtetësinë e tyre dhe me votim të fshehtë vendos përfshirjen e tyre në konkurrim, duke i renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrit. Më tej votohet për listën e pranuar, sipas një procedure të përcaktuar nga Këshilli Drejtues.
 - 2.4. Dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave kualifikohen për konkurrim të mëtejshëm. Nëse ndonjë kandidaturë që në votimin e parë të fshehtë të Këshillit Drejtues fiton 2/3 e votave, sipas nenit 99 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizion publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe të rregullores së Këshillit Drejtues, shpallet fitues.
 - 2.5. Dy kandidatët për konkurrim të mëtejshëm paraqesin në Këshillin Drejtues (veç e veç) obsionet e tyre konkrete për strukturimin, drejtimin e menaxhimit të RTSH-së dhe japin shpjegime para Këshillit Drejtues.
 - 2.6. Në rast se asnjë nga dy kandidatët nuk fiton 2/3 e votave, atëherë votimi përsëritet.

2.7.Kur pas votimit të dytë asnjë nga kandidatët nuk fiton numrin e votave të përcaktuara në ligj e në këtë statut, Këshilli Drejtues përsërit votimin me kalimin e një kohe treditore.

Këshilli Drejtues i RTSH-së shpall me vendimin përkatës kandidatin fitues dhe e bën atë menjëherë të njohur për publikun.

2.8.Drejtori i Përgjithshëm nuk lejohet të jetë në të njëjtën kohë deputet, anëtar i Qeverisë, anëtar i forumeve drejtuese të ndonjë partie politike, anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, pronar, bashkëpronar apo anëtar i çfarëdo subjekti të mediave private.

3. Kriteret e zgjedhjes dhe të emërimit të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorit Televizionit, të Drejtorit të Radio Tiranës dhe të drejtuesve të tjerë të të njëjtit nivel

3.1. Kriteret për përzgjedhjen e personave që do të emërohen në detyrat e mësipërme janë:

-të jenë shtetas të Republikës së Shqipërisë,

-të kenë kryer arsimin e lartë, përkatësisht me funksionin ku kandidohen,

-të kenë përvojë pune ose drejtuese të drejtpërdrejtë në median e shkruar ose audiovizuale.

3.2. Kandidatët duhet t'i paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm curriculum vitae të plotë, platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin drejtues ku kandidojnë.

3.3.Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, Drejtori i TV, Drejtori i Radio Tiranës dhe drejtuesit e tjerë të RTSH-së, të përcaktuar nga ky statut si të të njëjtit nivel, nuk mund të jenë në të njëjtën kohë deputetë, anëtarë të Qeverisë, anëtarë të forumeve drejtuese të ndonjë partie politike, anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, pronarë, bashkëpronarë apo anëtarë të çfarëdo subjekti të mediave private.

4. Procedurat e zgjedhjes, të emërimit të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorit të TV, të Drejtorit të Radio Tiranës dhe të drejtuesve të tjerë, të përcaktuar në këtë statut si të të njëjtit nivel

4.1.Drejtori i Përgjithshëm, në bazë të kriterëve të mësipërme, bën studimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave dhe për çdo nivel drejtimi, si rregull, i paraqet Këshillit Drejtues më shumë se një kandidat, përkatësisht me dokumentet e secilit. Renditja e kandidatëve bëhet në përputhje me vizionin që Drejtori i Përgjithshëm ka për RTSH publik.

4.2.Këshilli Drejtues, kur e çmon të nevojshme, i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm sqarime plotësuese për kandidatët.

4.3.Kandidatët votohen sipas radhës së propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Kur kandidati i parë nuk fiton shumicën e thjeshtë të votave, kalohet në votim të kandidatit pasardhës.

4.4.Nëse asnjëri nga kandidatët e votuar veç e veç nuk fiton shumicën e thjeshtë të votave, atëherë bëhet votimi përfundimtar për të gjithë kandidatët dhe shpallet fitues kandidati që fiton më shumë vota.

4.5.Në mungesë të kandidaturave alternative, Këshilli Drejtues voton edhe një kandidaturë të vetme, me kusht që personi i propozuar të marrë votat e nevojshme.

4.6.Këshilli Drejtues shpall fituesit me vendimin përkatës, të cilin e bën publik.

5. Largimi nga detyra

5.1.Në kushtet e kalimit të RTSH-së nga transmetues shtetëror në publik dhe në vazhdimësi, Këshilli Drejtues i këtij institucioni ka për detyrë të ndjekë dhe të vlerësojë në proces punën e drejtuesve kryesorë dhe, kur e sheh të nevojshme, kërkon votëbesimin për vijimësinë e funksionit të secilit prej tyre. Largimi nga detyra bëhet në përputhje me kriteret e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në RSH" dhe/ose ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 "Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.